



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Sulltan Badalli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 11.03.2021 VI-020-189
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Leonora Bajrami, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 001/011-33086 për formimin e komisionit vlerësues për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

I miratuar më datë: 25.02.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 03.03.2021


Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 001/011-33086 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.	<p>Vendim i Kuvendit të Komunës Nr. 001/011-33086 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër, është në kundërshtim me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht nën 17 paragrafi 2 ku sqarohet se :Kryetari i komunës i propozon dy (2)anëtarët nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy(2) anëtarët nga Kuvendi i Komunës në radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe një(1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal, si dhe pika 3 në të cilat sqarohet se: Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtareve të komisionit aprovohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtareve prezent dhe që votojnë.</p> <p><i>Ne rastin konkret në vendimin e miratuar për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër, nuk janë emrat e dy anëtareve nga ekzekutivi i Komunës.</i></p> <p>Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, duhet ta rishqyrtoj këtë vendim dhe aktin ta harmonizoj në harmoni me legjislacionin në fuqi.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Za :	Mytaher Haskuka, gradonačelnik Opštine Prizren Sulltan Badalli, predsedavajuća Skupštine opštine Prizren	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MLS,	
Od:	Venera Qerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MLS	Datum, 11.03.2021. br. 020-189
Odgovorni službenici: 1.Službenik za utvrđivanje zakonske procene 2.Službenik-ca za izradu zakonske procene	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Leonora Bajrami, službenica za montorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Prizren	
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Ministarstvo lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine br. 001/011-33086 o formiranju komisije za procenjivanje, davanja opštinske imovine na kratkoročno korišćenje.
Usvojena dana, 25.02.2021. godine,
Predložena za razmatranje u MLS, dana, 03.03.2021. godine,

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ocenilo je, da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:


Br.	Formulisane u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka Skupštine opštine br. 001/011-33086 o formiranju komisije za procenjivanje, davanja opštinske imovine na kratkoročno korišćenje.	<p>Odluka Skupštine opštine br. 001/011-33086 o formiranju komisije za procenjivanje, davanja opštinske imovine na kratkoročno korišćenje, je u suprotnosti sa Zakonom br. 06 / 1-092, o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, <i>odnosno član 17. stav 2. koji pojašnjava da: gradonačelnik opštine predlaže dva (2) člana iz izvršne vlasti opštine, Skupština opštine predlaže dva (2) člana iz Skupštine opštine u redovima različitih političkih subjekata i jednog (1) člana iz nevladinog sektora, koji predlaže lokalni nevladin sektor, kao i tačka 3 koja pojašnjava da: Odluku o imenovanju i razrešenju članova komisije, Skupština opštine odobrava većinom glasova članova, koji su prisutni i glasaju .</i></p> <p><i>U konkretnom slučaju u odluci koja je odobrena za formiranje komisije za procenu o davanju opštinske imovine na kratkoročno korišćenje, nedostaju dva imena članova iz izvršne vlasti opštine.</i></p> <p>Stoga, na osnovu gore navedenog, Skupština opštine Prizren treba razmotriti ovu odluku i uskladi akt u skladu sa važećim zakonodavstvom na snazi.</p>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave *zahteva* od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine, preduzimanje konkretnih mera, kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, shkronja d), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 17 dhe 19 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e proceduarve të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe në bazë të neni 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008. Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur me 25 shkurt 2021 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE
NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

Neni 1

Themelohet Komisioni vlerësues për vlerësimin ekonomik të ofertave pas mbylljes së ankandit-tenderit. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarësh, nga Kuvendi i Komunës janë: Kastriot Krasniqi, Ilir Baldedaj, dy (2) përfaqësues nga ekzekutivi i Komunës që do të propozohen me shkrim nga Kryetari i Komunës dhe Bashkim Gashi nga OJQ-të.

Nga përbërja e tyre, anëtarët e Komisionit në mbledhjen e parë e zgjedhin kryesuesin e këtij Komisioni. Për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës për shpalljen e tenderit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale formohet komisioni vlerësues.

Neni 2

Kompetencat e Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të objekteve-lokaleve dhe hapësirave publike pronë komunale, do të jenë ato kompetenca të parapara konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e proceduarve për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 01/011-40587 i dt. 15 mars 2018, i Kuvendit të Komunës për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e ofertave.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komisionit Vlerësues dhe Drejtoria e Administratës-Sëktori për Çështje Pronësore Juridike dhe njësit tjera përkatëse të Administratës së Komunës që i ofrojnë përkrahje Komisionit të Ankesave.

Neni 5

Ky Vendim, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011 - 33086
Më: 25 shkurt 2021
Prizren

